



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 64/12
Prishtinë, më 16.05.2012, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontic, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi., Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa dhe Albana Fetoshi.

Mungoi: Naser Osmani.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Ardita Fejza (praktikante), Dafina Krasniqi (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Gani Koci zv. Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Nazmi Zenelaj nga MZHE, Ibrahim Gashi zv. Ministër nga MPJ, Istret Azemi Udhëheqës i Dep. të Buxhetit të Kuvendit të Kosovës, Haxhi Gashi nga USAID, Elizabeta Gjioda dhe Visar Bikliqi nga NDI, Rejhane Zylfijaj nga GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Marrëveshjes për statusin e forcave (SOFA) në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e realizuar përmes shkëmbimit të Notave verbale ndërmjet Ministrisë të Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Zëvendës Sekretarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, më 18 shkurt 2012;**
3. **Shqyrtimi i projektligjit nr.04/L-102 për komunikimet elektronike me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
4. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve;**
5. **Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit për tre muajt e parë të vitit 2012;**
6. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës miratohet njëzëri.

2. Shqyrtimi i Marrëveshjes për statusin e forcave (SOFA) në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e realizuar përmes shkëmbimit të Notave verbale ndërmjet Ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Zëvendës Sekretarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, më 18 shkurt 2012

Kryetarja, njoftoi se marrëveshja në fjalë, e proceduar për shqyrtim në Komision, nga materiali shifet se nuk përmban materialin e nevojshëm për tu trajtuar në formën e marrëveshjes.

Ibrahim Gashi, u pajtuar me vërejtjet se kjo nuk i përmbush kushtet për t'u shqyrtuar në Kuvend sepse nuk e ka formën e një marrëveshjes ndërkombëtare por është në nivel të notave verbale të shkëmbyer mes dy shteteve. Pajtohem që të marrim informacione shtesë nga zyrat ligjore të Presidencës e cila e ka adresuar këtu pasi marrëveshjet e tilla që kanë të bëjnë me imunitet dhe privilegjet të shteteve është kompetent Presidenti i Shtetit në domenin e të drejtave të tij, që kanë të bëjnë me politikën e jashtme dhe të shtyhet në një mbledhje të radhës për shqyrtim.

Kryetarja, me që ndihet nevoja për konsulta shtesë, me Zyrën e Presidentes se cila ishte arsyeja që e ka adresuar këtu se nuk kemi ndonjë informatë në shkresën që na është drejtuar, pajtohem që ta shtyjmë për një mbledhje tjetër, dhe kjo notë verbale të merr formën e marrëveshjes dhe ne pastaj të kemi të drejtën tonë për ta bërë ratifikimin.

Pas diskutimeve dhe propozimit, Komisioni nxori këtë

PËRFUDNIM

Marrëveshjes për statusin e forcave (SOFA) në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shtyhet për shqyrtim në një mbledhje tjetër të komisionit.

3. Shqyrtimi i projektligjit nr.04/L-102 për komunikimet elektronike me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetarja, theksoi se kemi të bëjë me një projektligj, i cili përmban implikime buxhetore shtesë dhe nuk është rregulluar si duhet çështja e buxhetit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike, pagat e anëtarëve të bordit, statusi i stafit të këtij autoriteti, struktura organizative dhe të hyrat që realizon ky autoritet. Prandaj ka nevojë për disa sqarime shtesë në nenet që trajtojnë këto qeshte, sidomos për nenin 79 dhe nenin 81 dhe 83.

Gani Koci, të gjitha agjensionet rregullative ose jorregullative por që janë të pavarura duhet të trajtohen në bazë të LMFPP dhe gjë që nuk e kam parë në këtë në projektligj në pjesën sa i përket organit rregullativ të telekomunikacionit. Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka kërkuar që bordi ekzekutiv dhe stafi teknik profesional të kenë një trajtim të veçantë për shkak të specifikave, sepse këto administrojnë pasuri që është kombëtare dhe duhet të trajtohen pak më ndryshme. Autoriteti duhet të raportojë para Kuvendit, duhet planin buxhetor t'ia paraqesin Kuvendit.

Kryetarja, theksoi se do të doja që të bëjmë ligjin për institucionin dhe jo individin, sepse mënyra se si janë adresuar disa çështje tek neni 79 dhe neni 83, janë të adresuara çështjet më tepër te individit dhe jo të institucionit dhe ne duhet t'i bëjmë përmisimet e duhura ta rregullojmë mënyrën e duhur që mos të dalim jashtë kriterëve ligjore të cilat egzistojnë, jashtë ligjeve të cilat i kemi në disponim.

Bedri Hamza, duhet të ndryshohet çështja që flet se stafi i autoritetit nuk është staf civil. Neni 81 është në kundërshtim me ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe duhet të harmonizohet me këtë ligj të gjitha të hyrat sepse ligji ia jep autoritetin këtij institucioni t'i mbledh dhe duhet t'i derdhë në llogarinë e vetme të thesarit. Po ashtu duhet të rregullohet që Kuvendi të vendos për pagat e anëtarëve të bordit, ndërsa neni 83 gjithashtu do të thotë të rregullohet në harmoni me ligjin për financa publike.

Kryetarja, në bazë të asaj qfarë dëgjuam nga personat përgjegjës, asaj qfarë është shënuar në projektligj dhe qfarë është detyrë e jona, e shoh të arsyeshme të formojmë një grup punues që të gjejmë mënyrën që të harmonizohet ky ligj me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Qëllimi është që autoriteti ta ruaj pavarësinë e vet financiare, por janë edhe disa çështje që kërkon të analizohen, ku nuk është e përcaktuar mirë se si ky autoritet i raporton Kuvendit. Pastaj është problem edhe një amendament që e ka dhënë komisioni funksional që e trajton këtë institucion si një organizatë jobuxhetore.

Latif Gashi, jam dakord për të bërë një grup punues pasi ka shumë nene kontestuese, dhe të punohet së bashku me përfaqësuesit e dy ministrive, mundësisht ekspertë që kanë punuar në ligj e jo zëvendësministri për të harmonizuar qëndrimet sidomos me ato çështje që bien në kundërshtim me ligjet tjera.

Hykmete Bajrami, nga ajo që u diskutuar, vërejtjet kryesisht janë të projektligjit dhe jo të amendamentet e komisionit funksional. Nuk e kam shumë të qartë, që përfaqësuesit e Ministrisë së zhvillimit ekonomik bëjnë vërejtje thelbësore në projektligj, kur dihet se projektligji është i sponzorizuar nga vetë kjo ministri. Çështja tjetër është se projektligji votohet në mbledhjen e Qeverisë dhe do të duhej të shikohen mirë projektligjet sa i përket anës financiare para se të dërgohen në Kuvend. Nuk pajtohem me propozimin që të krijohet grupi punues për të punuar në dispozitat e projektligjit.

Sali Asllanaj, mendojë që duhet kthyer raportin Komisionit funksional, me rekomandimet që të shqyrtojnë nenet që janë në kundërshtim me ligjin mbi financat publike.

Kryetarja, nenet të cilat kanë të bëjnë direkt me financa nuk janë kompetencë e komisionit funksional dhe kjo qeshte është ekskluzivisht e lidhur me komisionin tonë, është çështja e pagave të bordeve dhe stafit, dhe çështja e të hyrave dhe mënyrës së hartimit dhe miratimit të buxhetit të tyre.

Xhevdet Neziraj, theksoi se ne kemi pas probleme me këto agjensione, është mirë të rregullohen sa më shpejtë së në këtë formë do ti zgjedhim problemet. Duke parë se ka mjaftë vërejtje në këtë projektligj, do të duhet që bashkarisht me komisionin funksional, t'i zgjedhim këto probleme ne pjesën financiare dhe t'a tejkalojmë këtë situatë.

Kryetarja, meqenëse është çështje shumë e rëndësishme dhe ne kemi me u përball si komision, unë propozoj që t'a formojmë një grup punues dhe besoj që brenda një dite do ti kemi sugjerimet këtu por t'i analizojmë më përpikëri që t'a rregullojmë më mirë dispozitat dhe nenet kontestuese.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

I. Caktohet grupi punues në përbërje të Safete Hadergjona, Jelena Bontic, Sali Asllanaj dhe Xhevdet Neziraj, i cili duhet të shqyrtoj projektligjin dhe amendamentet e komisionit funksional, dhe të dal me rekomandime konkrete për Komisionin.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve

Kryetarja, theksoi se projektligji ka për qëllim caktimin e një takse rrugore që e paguajnë pronaret e automjeteve më rastin e regjistrimit të automjeteve në qendrën e regjistrimit të automjeteve, dhe për taksën ekologjike që paguhet në baza vjetore më rastin e regjistrimit të automjeteve.

Bedri Hamza, theksoi se një prej arsyeve të këtij projektligji është ndryshimi i rregullores së UNMIK-ut dhe shëndrimi i saj në ligj. Me këtë projektligj përcaktohet një takse fikse rrugore për automjetet, po ashtu në atë do të përfshihen edhe një taksë ekologjike e cila është taksë vjetore, që do të jetë e përcaktuar në bazë të llojit të automjeteve e cila do të paguhet nga të gjitha personat fizik dhe juridik që e përdorin automjetin rrugor dhe automjetet e tyre ndihmëse në territorin e Republikës së Kosovës. Taksa ekologjike është propozuar të jetë 10 euro për automjetet nën 3.5 ton në vit dhe 30 euro për automjetet mbi 3.5 ton. Kësaj takse poashtu do t'i nënshtrohen edhe automjetet e huaja të cilat hyjnë në Republikën e Kosovës. Hartimi i ligjit bëhet më përputhje me praktikën e vendeve fqinje dhe vendeve të BE-së dhe standardeve ndërkombëtare të pranuar në lidhje me këtë fushë dhe është në harmoni me traktatin e Kopenhagës dhe me protokollin e Kiotos. Po ashtu, shumica e shteteve të regjionit e aplikojnë këtë taksë ekologjike dhe është më e lartë se kjo që ne e kemi propozuar. Taksat të cilat mblidhen nga ky destinacioni sigurisht që më propozimin e Qeverisë dhe vendimin e Kuvendit mund të kthehen përsëri dhe të investohen në ambient. Vlerësimet mbi impaktin buxhetor të ndryshimit të kësaj takse sugjerojnë që për gjashtë muaj mund të jenë 2.7 milion euro.

Sali Asllanaj, parimisht e përkrah këtë propozim por kisha dashtë që taksa ekologjike ta këtë destinimin direkt ekologjik më ligj të rregullohet jo pastaj të merret vendimi për destinimin e të hyrave që inkasohen nga kjo taksë. Pastaj, në nenin e fundit thuhet se hynë në fuqi më 1 korrik është një praktikë që po më duket jashtë logjike.

Hykmete Bajrami, është pak problem që neve të destinojmë të gjitha mjetet që mblidhen nga taksa ekologjike dhe t'i ndajmë në llogari të tjera. Ka pasur vërejtje në dy buxhetet që i kemi aprovuar se po ndahen pak mjete për mbrojtjen e ambientit, kështu që pasi po shtohet kjo taksë t'a kemi parasysh që në buxhetin e vitit të ardhshëm të ndahen më shumë mjete për mbrojtjen e ambientit. Në të njëjtën kohë po duket që neni 4 më nenin 5 disi janë pak si kundërtënjësë. Po themi që inkasimi i taksës rrugore dhe ekologjike për veturat e regjistruara në Kosovë bëhet nga qendra e regjistrimit të automjeteve që nënkupton pas 1 korrikut kur pritet ligji të hyj në fuqi dhe eventualisht askush nuk ka më mujt më regjistrua makinën pa e pague taksën ekologjike dhe rrugore. Pastaj e kemi nenin 6 ku thotë dëshmia e pagesës dhe kontrollit do të vendoset dikun në këndin e poshtëm të djathtë të gjamit të përparmë të automjetit, dhe nëse vetura është e regjistruar ajo nënkupton që taksa është e paguar. Sa i përket veturat e huaja që hyjnë në territorin e Kosovës është mirë që të ceket që paguhet vetëm njëherë në vit.

Latif Gashi, këtu kemi të bëjmë edhe me automjetet që lirohen nga taksa rrugore dhe ekologjike edhe në lidhje me këtë duhet të na tregoni për cilat automjete?

Bedri Hamza, mjetet që grumbullohen nga kjo taksë të shkojnë në destinacionin për të cilin grumbullohen të rritet buxheti i Ministrisë së Ambientit. Çështja e tjetër po mendojë që është kohë e mjaftueshme deri më 1 korrik që ne t'a finalizojmë këtë ligj.

Pas diskutimeve dhe sugjerimeve, Komisioni nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve

4. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit për tre mujorin e parë të vitit 2012

Istret Azemi, në raport shihet se kemi një progres prej 51,71% të buxhetit tremujor, ndërsa një progres vjetor prej 17,66%, raporti është i detajuar. Krahësuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, shohim se në vitin 2012 kemi shpenzime më të mëdha. Te projektet kapitale deri më tani kemi paguar vetëm atë pjesën që një pjesë të projekteve të bartur nga viti i kaluar furnizimi me mobile për aneksin.

Hasime Krasniqi, nga raporti shifet se shpenzimet kapitale të Kuvendi i Kosovës vazhdimisht janë në nivelin jo të kënaqshëm. Po ashtu marrë në përgjithësi nuk është bërë shfrytëzimi i buxhetit në bazë të % për tremujorin e parë. Po ashtu raporti i mungojnë të dhënat për muajin e tretë, si për paga dhe shpenzime të tjera, dhe nuk mund të konsiderohet raport tremujor, por është një raport dymujor me të dhëna të mundshme dhe kisha kërkuar që këto raporte të plotësohen për muajin e tretë dhe ta quajmë raport tremujor. Një vërejtje të shënimet ku paraqitet numri i të punësuarve, për administratën, stafi politik, të na ofrohet një listë e pagave të stafit mbështetës dhe shërbyesve civil.

Kryetarja, te pika 6 në kolonën 6/1 kemi paraqitur buxhetin e ndryshuar pasi është bërë një transfer prej 3,000 euro nga programi deputetët e kuvendit, nga kategoria paga dhe meditje në programin stafi mbështetës politik po në kategorinë paga dhe meditje. Pse është bërë ky transfer, dhe pse komisioni për buxhet dhe financa, nuk qenë i njoftuar me këtë transfer?

Istret Azemi, te investimet kapitale kemi filluar me disa projekte që janë në procedurë të tenderit. Për çdo tremujor ne duhemi të barazohemi me departamentin e thesarit dhe është politikë e Qeverisë që pagat e muajit aktual të bëhen shpenzim në muajin vijues. Te numri i të punësuarve dhe lista e shërbyesve civil dhe stafit politik në raportet e viteve të mëparme ka qenë e bashkangjitur, mirëpo ka qenë një rekomandim që ajo pjesë të heqet nga raporti. Te transferet një pjesë e kërkesave tona kanë mbetur pa u përfshirë dhe si rrjedhojë e kësaj që me pagat e muajit janar kemi pasur mungesë të fondeve për të dalur nga kjo situatë kemi parë të arsyeshme ta bëjmë një transfer në fillim të shkurtit nga programi i deputetëve në programin e stafit mbështetës politik prej 33,000 euro, dhe kjo ka ndodhur për mungesës së deputetëve në komisione, seanca e pamë të arsyeshme ta bëjmë këtë transfer.

Kryetarja, sikur të ishte pas 3 ose 4 muaj të bënit transfer do të kishte logjikë por në fillim të vitit pas një planifikimi të bërë të buxhetit që kam hezitime se si po e bëni planifikimin e buxhetit fillimisht, sepse gjatë planifikimit të buxhetit duhet të jeni në gjendje të paraqitni një pasqyrë të qartë të detalizuar, qfarë keni planifikuar sepse kto janë mandej pasojat dhe një transfer i tillë që në muajin shkurt nuk e ka logjikën.

Muhamet Mustafa, një shpenzim shumë i lartë për kategorinë dreka zyrtare? Sugjerojmë të analizohet kjo çështje.

Istret Azemi, te drekat zyrtare kanë mbetur obligime të papaguara nga viti i kaluar muaji nëntor dhe dhjetor për shpenzimet e reputacionit në kuvend. Në këtë kategori hyjnë edhe shpenzimet e vizitave të ndryshme që i bëjmë Kuvendit dhe shpenzimet e komisioneve parlamentare.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë raportin e shpenzimeve të Kuvendit për tre mujorin e parë të vitit 2012.

Mbledhja përfundoi: 11:20

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj